

NJOFTIM PUNE

POZICIONI I PUNËS: ROJE MJEDISOR
NATYRA E PUNËSIMIT: POZICION ME KOHË TË PLOTË
RAPORTON TE: MENAXHERI I SHËRBIMEVE PËR VIZITORËT
VENDI I PUNËS: PARKU KOMBËTAR I BUTRINTIT

PËRSHKRIMI I POZICIONIT TË PUNËS

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit shpall vend vakant për pozicionin **“Roje Mjedisor”**, me qëllim mbrojtjen, monitorimin dhe administrimin e territorit të Parkut Kombëtar të Butrintit, duke garantuar ruajtjen e biodiversitetit, trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe respektimin e rregullave nga vizitorët dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet brenda parkut.

Detyrat kryesore:

- Monitoron dhe mbron ekosistemet, florën dhe faunën e parkut kombëtar.
- Kryen patrullime periodike për parandalimin e dëmtimeve mjedisore, gjuetisë dhe prerjeve ilegale.
- Identifikon dhe raporton ndotjen, zjarret pyjore, erozionin dhe çdo rrezik tjetër mjedisor.
- Siguron zbatimin e ligjeve dhe rregullave për mbrojtjen e mjedisit dhe zonave të mbrojtura.
- Ndihmon në ruajtjen e biodiversitetit dhe habitateve natyrore.
- Merr pjesë në aktivitete rehabilitimi dhe mirëmbajtjeje të zonave natyrore, shtigjeve dhe tabelave informuese.
- Informon dhe ndërjegjëson vizitorët mbi rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe sjelljes ekologjike.
- Mbledh të dhëna mjedisore dhe harton raporte për gjendjen e territorit.
- Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për emergjencat mjedisore dhe menaxhimin e parkut.

- Ndihmon në organizimin e aktiviteteve edukative dhe ekologjike për komunitetin dhe vizitorët.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Arsim i mesëm ose universitar
- Përvojë e mëparshme në pozicione të ngjashme përbën avantazh

Kualifikimet e Preferuara:

- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi
- Integritet, përgjegjësi dhe korrektësi në punë
- Gatishmëri për të punuar me turne
- Njohuri mbi biodiversitetin trashëgiminë kulturore dhe natyrore
- Njohuri të mira të gjuhës angleze, gjuhët e tjera përbëjnë avantazh

DOKUMENTAT PËR DORËZIM

- CV (Curriculum Vitae)
- Letër motivimi
- Kopje e kartës së identitetit

Procesi i aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet e tyre në gjuhën shqipe, në adresën e mëposhtme careers@bmf.al (referoni titullin e punës në email-in tuaj), ose mund të sillen edhe dorazi pranë Fondacionit .

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për një intervistë. Kandidatët duhet të jenë të disponueshëm për të zhvilluar intervistën dhe mund t'u kërkohej në çdo faze që të sigurojnë dëshmi të përvojës dhe arritjeve të tyre profesionale.

Afati për aplikime është deri më 17 Korrik 2026.

Për pyetje, kontaktoni: info@bmf.al